

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Më shumë se një shkollë, gjuha shqipe në Firenze nis vitin e dytë të misionit të saj identitar
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/me-shume-se-nje-shkolle-gjuha-shqipe-ne-firence-nis-vitin-e-dyte-te-misi-i588607
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA

KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 17:43:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 17:42:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bfbbed2e5b0f48c5a8b6f73daf163a3d07e1a6b4cac4a6edaa53252e8ad739d8
TEKSTI	cb481b5497a943d25ae4edbfd4c56107bea5abcc45b3b89ec878bb576a3f81e4
PAMJA	0cba46402209b5240c269ee1cdf10727dbb0331bbcb2c3be2930cadd8ecdffc0a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	61883c26113e4e1f8216db4e5977d6f907d7a665c49f6dd81fbaecd16abe5ad1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f1d82a646bd703b2c3db300ad07fe31d63113d7410715c948367b3c04c7e5621
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/61883c26113e4e1f8216db4e5977d6f907d7a665c49f6dd81fbaecd16abe5ad1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by



English



Me shumë se një shkollë, gjuha shqipe në Firence nis vitin e dytë të misionit të saj identitar. Na ndërpreu takimin dhe mallkoi banoret. Brace reagon pas perplasjes me a fundit

Më shumë se një shkollë, gjuha shqipe në Firence nis vitin e dytë të misionit të saj identitar



26 Shtator 2026, 19:42Kulturë TEMA



Në zemër të Toskanës, komuniteti shqiptar hap dyert e vitit të dytë të shkollës së gjuhës amtare. Një nismë që po shndërrohet në një institucion të qëndrueshëm për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të fëmijëve të diasporës.

FIRENCE – Në qytetin ku arti dhe historia italiane ndërthuren në çdo cep, komuniteti shqiptar ka vijuar traditën e nisur një vit më parë, duke çelur zyrtarisht vitin e dytë të veprimtarisë së shkollës shqipe. Kjo nismë, tashmë në rrugën e konsolidimit, synon të mbajë gjallë lidhjen e brishtë, por të fortë, mes fëmijëve të lindur apo rritur në Itali dhe rrënjëve të tyre kulturore.

Rikthimi në bankat e shkollës pas pushimeve verore u shoqërua me entuziazëm dhe emocione të sinqerta. Për nxënësit e vjetër ishte një ribashkim me shokët, shoqet dhe mjedisin e tyre gjuhësor, ndërsa për fytirat e reja, dita e parë solli emocionin e njohjes me Abetaren.

Pamja e fëmijëve që mbajnë në duar librat e tyre në gjuhën shqipe, brenda një mjedisi evropian, përbën një dëshmi të qartë të përkushtimit familjar dhe komunitar për ruajtjen e gjuhës amtare.

Një nga zhvillimet më domethënëse të këtij viti të dytë është zgjerimi i trupës pedagogjike. Përfshirja e dy mësueseve të reja, të cilat u prezantuan gjatë ditës së hapjes, tregon rritjen e organizimit dhe vullnetin e komunitetit për t'i dhënë kësaj nisme vazhdimësi dhe standarde gjithnjë e më të mira profesionale.

Përtej mësimt të alfabetit, rregullave gramatikore dhe pasurimit të fjalorit, klasa funksionon edhe si një hapësirë kulturore. Këtu, fëmijët ushtrojnë aftësinë për të dëgjuar, folur, lexuar dhe shkruar shqip, duke përballuar sfidën e një përditshmërie ku italishtja mbetet gjuha mbizotëruese e shkollës, shoqërisë dhe komunikimit të përditshëm.

Ruajtja e gjuhës amtare në emigracion mbetet një nga sfidat më të rëndësishme për familjet shqiptare. Ajo kërkon një bashkëpunim të vazhdueshëm mes mësuesve, prindërve dhe fëmijëve, si dhe përpjekje që shqipja të përdoret jo vetëm në klasë, por edhe në jetën e përditshme familjare.

Misioni i shkollës nuk kufizohet vetëm te mësimi i gjuhës. Përmes saj, fëmijët kanë mundësinë të komunikojnë më natyrshëm me gjyshërit dhe të afërmit, të njohin më mirë historinë e familjeve të tyre dhe të ruajnë lidhjen me kulturën dhe trashëgiminë nga e cila vijnë.

Në këtë proces, shkolla dhe familja bëhen dy shtylla të së njëjtës përpjekje, që gjuha shqipe të mos mbetet vetëm një kujtim i brezit të prindërve, por të vazhdojë të jetë një gjuhë e gjallë për brezat që rriten larg vendit të origjinës.

Në përfundim të ditës së parë, mes librave, fletoreve dhe detyrave të reja, mbetet i qartë një angazhim i përbashkët, që shqipja të vazhdojë të flitet, të lexohet dhe të shkruhet edhe nga brezat e ardhshëm.

Në Firencën e Rilindjes, ky vit i dytë i shkollës shqipe shënon një tjetër hap në ndërtimin e urave mes brezave, mes kulturave dhe, mbi të gjitha, mes fëmijëve shqiptarë dhe rrënjëve të tyre.

Për shoqatën kulturore shqiptare "Adriatiku" Firenze, Zogë Idrizi Loshi!

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Banda që luante rock

19:16 Kulturë

"Shkodra ka plot dashuri" vjen në skenën e Teatrit Migjeni

17:23 Kulturë

Kremtim solemn me rastin e ditës së emrit të Kryebariut tonë të dashur, Fortlumturisë së Tij, Joani (FOTOT).

16:08 Kulturë / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.